Olesia Leço

BON TON

Etiketa, një mënyrë jetese e kulturuar

BOTIME

pegi

PARATHËNIE

Në një shoqëri ku marrëdhëniet, të cilitdo lloj qofshin ato, normat i kanë si rregullator të tyre, etiketa si një kod sjelljeje, mund të konsiderohet si vlerë e veçantë dhe e domosdoshme. Një vlerë, e cila vjen si një përsosje e këtyre normave në formën më të hollë dhe elegante. Mirësjellja, hijeshia dhe paraqitja si duhet në shoqëri, në përditshmëri dhe në çdo rast të veçantë, të rëndësishëm, festiv etj., përveçse mënyrë komunikimi dhe jetese, janë tregues të këndvështrimit për botën dhe të mënyrës se si ti vetë pozicionohesh në të, si një individ i veçantë, por njëkohësisht edhe si qenie sociale.

Në një shoqëri si kjo e jona, e cila ka kaluar e ndoshta po kalon sprova të vështira, etiketa duket si e lënë mënjanë, prandaj, një libër udhëzues i sjellë me një gjuhë të kuptueshme dhe i përshtatur për nevojat e komunikimit e të paraqitjes në shoqëri është ai që i duhet. Si duhet të sillemi me respekt ndaj të tjerëve? Si duhet të komunikojmë me ata që na rrethojnë, me njerëz të grupeve të ndryshme shoqërore, me eprorë, me kolegë, në ngjarje të rëndësishme, në udhëtim etj.? Si duhet të vishemi hijshëm, me stil dhe pa e tepruar? Cila është sjellja e duhur në çdo rast të jetës sonë? Njohja e rregullave të etiketës na vjen në ndihmë në çdo rast.

Kodi i mirësjelljes në shoqëri ka evoluar në kohë, duke iu përshtatur ritmit e mënyrës së jetesës. Mënyra se si ajo është vlerësuar, rëndësia që i është kushtuar etj. kanë qenë gjithnjë të lidhura me zhvillimet që vetë shoqëria ka pësuar. Rregullat bazë të saj janë të zbatueshme për secilin prej nesh, na japin çelësin e domosdoshëm, për t'u prezantuar denjësisht në shoqëri dhe sidomos, epërsinë e komunikimit të qytetëruar, të kulturuar dhe me vlera.

Dr. Brunilda Zenelaga

Sociologe

Përmbajtje

Hyrje		7
1.	Paraqitja te femrat	9
2.	Paraqitja te meshkujt	15
3.	Komunikimi, prezantimet, të folurit në shoqëri	23
4.	Intervistë pune	31
5.	Mikpritja	35
6.	Në tavolinë	43
7.	Në një tryezë orientale	51
8.	Rregullat për një piknik të qytetëruar	59
9.	Kafshët shtëpiake në komunitet	63
10.	Bashkëjetesa në pallat	67
11.	Të edukuar edhe në supermarket	69
12.	Mirësjellja te fëmijët, sjellja me dadot dhe ndihmësët në shtëpi	71
13.	Dhuratat`	81
14.	Thuaje me lule	85
15.	Teatër, kinema, event gjithmonë të edukuar	89
16.	Në udhëtim	95

17. Në hotel 103
18. Mikpritja për disa ditë 107
19. Mirësjellja në plazh 113
20. Aksesorë dhe gjeste që na kanë shoqëruar në çdo epokë 121
21. Netiketë, sjellja në kohën digjitale 131
22. Për shën valentin 135
23. Fejesa 143
24. Dasma 149
25. Etiketa e sjelljes në jetë të një bebeje 161

Hyrje

Përse duhet një libër mbi mirësjelljen në vendin tonë? Në kohën që jetojmë, në mes të një zhvillimi teknologjik, gjeografik dhe kulturor duhet të dimë normat e mirësjelljes për çdo rast, pasi çelësi i çdo raporti është mënyra si ne sillemi. Besoj të gjithë e dimë që në mjetet e transportit publik duhet t'i lirojmë vendin një të moshuari, që kur jemi në tryezë, duke ngrënë nuk mund të bëjmë gjeste të pahijshme si rrufitja me zhurmë e makaronave apo e një luge me supë etj. Nga ana tjetër duhet të theksojmë që rregullat e mirësjelljes kanë ndryshuar në kohë, duke iu përshtatur këtij mijëvjeçari dhe ritmit të tij me dëshirën për ta parë botën më të bukur.

Mirësjellja është ëndrra e të jetuarit në një vend që të buzëqesh gjithmonë, duke mos u dorëzuar përpara sjelljeve arrogante. Ajo nuk duhet kuptuar si diçka e trashëguar, si diçka që i përket vetëm një shtrese të caktuar të popullsisë apo si rregulla që i përkasin një të kaluare. Mirësjellja duhet të konsiderohet si një manual jetese, me të cilin mund të jetojmë më mirë.

Një shprehje e vjetër thotë "Eleganca e vërtetë është ajo që nuk bie në sy" dhe këtu e kam fjalën për mënyrën se si i prezantohemi të tjerëve. Kjo vlen për paraqitjen tonë, raportin më të tjerët, ftesat në një darkë apo pritjen e miqve, rregullat e komunikimit dhe të sjelljes në ambientet që ndajmë më të tjerët, duke vënë mirësjelljen si kryefjalë të një shoqërie të shëndoshë në rrugëtimin tonë të përditshëm.

1 PARAQITJA TE FEMRAT

Zgjodha ta nis këtë rrugëtim mbi rregullat e mirësjelljes me veshjen, pasi është kartëvizita jonë e parë, pamja e parë më të cilën përballemi dhe ndonjëherë opinioni i parë për një person vlen më shumë se njohja e mëvonshme. Të jesh elegant, të dukesh bukur në sytë e të tjerëve është në radhë të parë, një detyrë ndaj vetes. Çdokush nga ne duhet të jetë i kujdesshëm me veshjen, pa hequr dorë nga moda, duke ndërthurur me stilin personal elemente të saj. Ndodh shpesh që të rinjtë imitojnë veshje të personazheve të famshme dhe kjo nuk është e këshillueshme, pasi në radhë të parë duhet të vishemi në përputhje me aspektin tonë fizik. Nuk na bën medoemos, një veshje që mban emrin e një firme të njohur, të dukemi bukur, por ajo që është e pastër, e hekurosur mirë dhe që i përshtatet vendit ku do shkojmë. Duhet të prezantohemi sa më mirë në sytë e të tjerëve, por pa u dukur asnjëherë të ekzagjeruar dhe vetëm për të rënë në sy.

Femrat

Femrat ndonjëherë duket se më të lehtë e kanë të blejnë diçka të re sesa të kërkojnë një kombinim në dollapin e tyre.